

VAKSINIMI NË PRAKTIKË

Kur ta vaksinohet fëmijën tim?

Të vaksinosh fëmijën që prej moshës 11 vjeçare, do të thotë të garantosh një efikasitet më të madh të vaksinës

Fëmija im ka moshën:

- nga 11 deri në 14 vjeç: vetëm dy doza janë të nevojshme;
- nga 15 deri në 19 vjeç (rikuperim): tre doza janë të nevojshme.

Mirë për ta ditur: përfitoni nga takimi vaksinal për përforsimin dTcaP*, parashikuar midis moshës 11 dhe 13 vjeçare, për të bërë në të njëjtën kohë një nga dozat e vaksinës kundër HPV.

* Vaksina kundër difterisë (D), tetanozit (T), pertusis (Ca) dhe poliomelitit (P).

Si ta vaksinohet fëmijën tim?

Për vajzat dhe për djemtë, unë i adresohem:

- një mjeku
- një farmacisti
- një mamie
- një infirmieri
- një qendër vaksinimi të bashkisë apo të departamentit (pyesni pranë bashkisë suaj apo këshillit të departamentit).

Cilat mund të jenë efektet anësore të padëshirueshme?

Efektet anësore të padëshirueshme të cilat vihen re më shpesh sipas studimeve klinike të bëra janë të njëjtat si për vaksinat e tjera: reaksion tek vendi ku është bërë gjilpëra (të skuqura, dhimbje dhe/ose inflamacion), dhimbje koke, marrje mendsh ose temperaturë, dhe më rrallë, reaksione alergjike ose gjendje të fikëti me humbje të vetëdijes. Këto efekte anësore të padëshirueshme në përgjithësi janë të lehta ose mesatarisht të rënda dhe zgjasin një kohë të shkurtër.

Sa kushton vaksinimi kundër HPV?

- Çdo dozë vaksinimi merret përsipër 65% nga fondi i sigurimit shëndetësor. Pjesa tjetër në përgjithësi rimboursuhet nga siguracioni shtesë (siguracioni plotësues...).
- Vaksinimi mund të jetë falas në disa qendra vaksinimi, të bashkive apo të departamenteve.
- Për personat të cilat përfitojnë Siguracionin Shëndetësor Plotësues Solidar (CSS) dhe ndihmën mjekësore të shtetit nuk kanë asgjë për të paguar.

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS PËR TË MBROJTUR FËMIJËN TIM KUNDËR KANCERËVE HPV.

FËMIJA JUAJ ËSHTË I SHKOLLUAR NË KLASËN E 5^{të}, ME AUTORIZIMIN TUAJ:

- ai mund të vaksinohet në kolegji nga një profesionist shëndeti;
- ai do të marrë dy doza vaksine, brenda 5 muajsh minimumi;
- ju nuk keni asgjë për të paguar.

Deri më sot, më shumë se 100 milion fëmijë dhe adoleshentë janë vaksinuar në rreth 80 shtete.


Për të ditur më shumë, flisni me një profesionist shëndeti, ose merrni takim në vaccination-hpv.e-cancer.fr



AUSTRIE.GOV - Mos e hidhni në rrugë - INCa - SIREN:187512777 - Maj 2024 - DEP/VACC/HPV/EN24.

VAKSINIMI KUNDËR KANCERËVE HPV*

TË MBROJMË VAJZAT DHE DJEMTË QË PREJ MOSHËS 11 VJEÇARE.



UDHËZUES PRAKTIK

*HPV: Human Papillomavirus ose Papillomavirusi Njerëzor.

INFORMOHEM MBI VAKSINIMIN KUNDËR KANCERËVE HPV

Përse ta vaksinoj fëmijën tim?

Sot, vaksinimi kundër HPV parandalon deri në 90% të infeksioneve HPV të cilët mund të provokojnë kancera.

Ai rekomandohet për vajzat dhe për djemtë kundër:

- lezioneve prekanceroze dhe/ose kancerat e qafës së mitrës, të vulvës, të vaginës dhe të anusit;
- lezione beninje, por të dhimbshme, që dalin mbi lëkurë ose mukozat e anusit dhe të pjesëve gjenitale (lythat anogjenitale).

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS

Që prej më shumë se 15 viteve, më shumë se 300 milion doza të dhëna në botë

Një survejim ndërkombëtar i rreptë.

Përdorimi i gjerë i vaksinave kundër HPV, survejimet e aplikuara në shumë vende dhe në nivel ndërkombëtar si dhe rezultatet e studimeve specifike kanë konfirmuar profilin e tyre të shkëlqyer të sigurisë, të njohura nga OBSH.

Kështu, për shembull, nuk është vërtetuar asnjë lidhje midis vaksinave dhe sëmundjeve auto-immune.

Efikasiteti i vaksinimit kundër HPV vërehet në vendet ku numri i të rinjve në moshën madhore të vaksinuar është i madh, si në Australi (rënie e kancerëve dhe e lezioneve prekanceroze të qafës së mitrës si dhe të lytheve anogjenitale tek meshkujt dhe tek femrat).

INFORMOHEM MBI PAPILOMAVIRUSET NJERËZORE

HPV, çfarë janë?

HPV janë viruse njerëzore të quajtura papillomavirus. 80% e femrave dhe e meshkujve ekspozohen ndaj këtyre viruseve gjatë jetës së tyre. Në përgjithësi, infeksionet HPV zhduken brenda disa muajve, por një pjesë e vogël mund të qëndrojnë dhe të kthehen në sëmundje.

Cila është lidhja midis viruseve HPV dhe kancerave?

Ekzistojnë rreth 200 lloje HPV disa prej të cilave provokojnë lezione prekanceroze dhe kancera. HPV prodhojnë gjithashtu lythe anogjenitale.

Si transmetohen viruset HPV?

Këto viruse transmetohen thjesht nga një kontakt me pjesët gjenitale, më shpesh gjatë marrëdhënieve seksuale, me apo pa penetrim.

ÇDO VIT, NË FRANCË, 6 400 RASTE TE REJA KANCERI JANË SHKAKTUAR NGA PAPILOMAVIRUSET NJERËZORE.

Nëse kancerat HPV prekin përgjithësisht femrat, më shumë se çereku prekin dhe meshkujt

Numri i sëmundjeve HPV-i shfaqur tek femrat dhe tek meshkujt në Francë në 2015 (sipas Shield dhe al., Hartwig dhe al., 2015).

	MESHKUJ	FEMRA
Kancer i penisit / Kancer i vulvës dhe i vaginës	100	200
Kancer i anusit	400	1100
Kancer i orofaringut (goja,fyti...)	1300	400
Kancer i qafës së mitrës	—	2900
Lezione prekanceroze të vulvës, të vaginës, të anusit	130	rreth 2 500 deri në 3 000
Lezione prekanceroze të qafës së mitrës (CIN2+)	—	rreth 30 000
Lythe anogjenitale	rreth 50 000	rreth 50 000